

VENDIM
Nr.504, datë 1.5.2008

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.277, DATË 18.3.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË
VIKTIMAVE, TË SHKAKTUARA NGA TRAGJEDIA E DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN
GËRDEC, BASHKIA VORË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit e Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.277, datë 18.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 2, shifra “... 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë...”, zëvendësohet me “... 32 000 000 (tridhjetë e dy milionë) lekë...”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Shpenzimet e varrimit dhe të ceremonisë mortore për viktimat e tragjedisë së datës 15.3.2008 në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, të përballohen nga Ministria e Brendshme, me fondin e emergjencës, miratuar për vitin 2008.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha